

UNIVERSITETI I PRISHTINËS**Fakulteti i Arteve****PLAN- PROGRAMI MËSIMOR- SYLLABUS****VITI AKADEMIK 2024/ 2025****Të dhënat bazike të lëndes**

Njësia Akadematike:	Fakulteti i Arteve/ Programi Artet Vizuale/ Profili Pikturë
Titulli i lëndës:	Pikturë
Niveli:	Master- MA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë/ semestri I-II
Numri i orëve në javë:	6 (gjashtë) + 6 (gjashtë)
Vlera në kredi – ECTS:	24 (njëzet e katër)
Koha / lokacioni:	E hënë 09:00-11:15 h / Klasa e Pikturës Nr.106 E mërkurë 09:00-11:15 h / Klasa e Pikturës Nr.106
Mësimdhënësi i lëndës:	PROF. MR. VALBONA REXHEPI
Detajet kontaktuese:	E-mail: valbona.rexhepi@uni-pr.edu Mob.tel. +383 (0) 49 519 900
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda e Pikturës për nivelin Master është dizajnuar për të avancuar aftësitë krijuese, kërkimore dhe profesionale të studentëve përmes një kombinimi të mentorimit individual dhe qasjes grupore.</p> <p>Programi fokusohet në zhvillimin e një plani të personalizuar pune, i cili realizohet në bashkëpunim të ngushtë me mentorin, duke përfshirë punë intensive praktike në studio, shkrime të rregullta dhe seminare kërkimore.</p> <p>Studentët eksplorojnë metodat e avancuara të shprehjes në pikturë dhe trajtojnë diskurse bashkëkohore që ndikojnë në art, si revolucionin teknologjik, koleksionimi i artit dhe ndikimet sociale.</p>

	<p>Puna praktike mbështetet nga një program i detajuar shkrimesh javore, mujore dhe semestrare, të cilat formojnë bazën për temën e diplomës dhe ekspozitën përfundimtare. Ligjëratat, debatet dhe diskutimet synojnë zhvillimin kritik, artistik dhe intelektual të studentëve, ndërsa puna praktike kontribuon në formimin e një personaliteti të pavarur krijues dhe përvetësimin e teknikave bashkëkohore të artit. Programi përfundon me realizimin e një ekspozite origjinale dhe mbrojtjen e temës së masterit, duke përgatitur studentët për të hyrë në botën e artit si profesionistë të vetë-administruar dhe inovatorë.</p>
<p>Qëllimet e lëndës</p>	<p>Qëllimi i lëndës është të përgatisë studentët për të operuar si artistë të pavarur, kritikë dhe inovatorë në fushën e pikturës dhe artit bashkëkohor, duke kombinuar aftësitë krijuese dhe kërkimore me njohuri të avancuara teorike dhe praktike. Lënda synon që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të mësojnë të shkruajnë dhe të reflektojnë mbi punën e tyre, duke ndërtuar ide dhe synime të qarta për zhvillimin artistik dhe profesional. Të zhvillojnë aftësi për të analizuar dhe bërë kritikë të shkruar të veprave të artit, duke ndihmuar në përmirësimin e mendimit kritik dhe të shprehjes intelektuale. Të përfshihen në mënyrë aktive në debate shoqërore mbi artin dhe të diskutojnë në mënyrë të përgjegjshme për vlerat artistike dhe kulturore të veprave të artit. Të bashkëpunojnë me artistë të tjerë për të qenë pjesë e projekteve të mëdha artistike, duke forcuar aftësitë e tyre bashkëpunuese dhe profesionale. Të zhvillojnë dhe avancojnë punën e tyre krijuese në mënyrë të vazhdueshme, duke maksimalizuar potencialin e tyre artistik. <p>Të aftësohen për të përcjellë hulumtime dhe procese kreative të avancuara në fushat e interesit të tyre, duke kontribuar në diskurset bashkëkohore të artit.</p> <ul style="list-style-type: none"> Të përcaktojnë kritere të qarta për punën e tyre dhe të ndërtojnë një proces të strukturuar dhe të mirëorganizuar të krijimit artistik. Të eksplorojnë dhe praktikojnë teknika të reja në pikturë duke u bazuar në zhvillimet teknike dhe teknologjike bashkëkohore. Të identifikojnë vlerat dhe idetë e shprehura apo të nënkuptuara në punimet artistike, duke

	<p>përmirësuar aftësitë e interpretimit dhe të kritikës artistike. Të krahasojnë punën e tyre me standardet dhe sfidat e botës së artit bashkëkohor, duke reflektuar mbi evolucionin e vazhdueshëm të artit. Të zhvillojnë aftësi për vetë-administrim dhe menaxhim të karrierës së tyre si artistë profesionistë. Përmes këtij programi, studentët jo vetëm që do të avancojnë në krijimin artistik, por do të zhvillojnë një qasje të pavarur dhe kritike ndaj artit, duke kontribuar në mënyrë të qëndrueshme në botën e artit bashkëkohor.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Njohuritë</p> <p>Pas përfundimit të lëndës, studentët do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Njohin mediumet, materialet dhe teknikat më të avancuara në artin bashkëkohor dhe dinë t’i përdorin për të krijuar vepra artistike me vlera të pakontestueshme. ● Kuptojnë rrjedhat dhe zhvillimet kryesore të artit bashkëkohor, përfshirë mendimin kritik për artin e shekullit 21, inovacionet artistike, teknologjitë e reja dhe përdorimin e medimeve bashkëkohore. ● Njohin proceset e menaxhimit, plasimit dhe koleksionimit të artit si pjesë integrale e zhvillimit profesional. ● Kuptojnë rëndësinë e krijimit të veprave artistike të bazuara në koncepte që mbartin mesazhe të përgjegjshme dhe vlera të vërteta artistike. ● Kuptojnë ndikimin e teknikave dhe medimeve të ndryshme në krijimin e projekteve të mëdha artistike. <p>Shkathtësitë</p> <p>Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Realizojnë vepra artistike origjinale duke aplikuar teknika dhe materiale të avancuara dhe duke adresuar sfidat e artit bashkëkohor. ● Shkruajnë shkrime kritike, analitike dhe kërkimore lidhur me punën e tyre dhe të artistëve të tjerë, duke demonstruar aftësi të avancuara vlerësimi dhe reflektimi. ● Hulumtojnë në mënyrë të thelluar rrjedhat dhe zhvillimet e artit, duke trajtuar aspekte si inovacionet teknike, menaxhimi dhe teknologjia. ● Zhvillojnë projekte artistike të bazuara në koncepte të qarta dhe mesazhe artistike të forta, duke dëshmuar krijimtari dhe përgjegjësi artistike. ● Përfshihen në diskutime dhe debate profesionale, duke zhvilluar aftësi të shkëlqyera shprehëse në të shkruar dhe verbale.

	<ul style="list-style-type: none"> ● Përballen me sfidat që i parashtrojnë vetes dhe ato të komunitetit artistik, duke ndjekur standardet më të larta të artit bashkëkohor. <p>Kompetencat</p> <p>Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Projektojnë dhe realizojnë punime artistike që plotësojnë standardet më të larta artistike dhe adresojnë sfidat e komunitetit artistik. ● Adresojnë si artistë profesionistë aktivë në skenën artistike ndërkombëtare, duke kontribuar me projekte origjinale dhe hulumtime të avancuara. ● Vetë-administrojnë karrierën e tyre artistike dhe integrohen me sukses në projekte dhe ngjarje të rëndësishme artistike. ● Zhvillojnë një qasje të pavarur dhe kritike ndaj zhvillimeve të artit bashkëkohor, duke qenë pjesëmarrës aktivë në komunitetin artistik. ● Demonstrtojnë përgatitje të shkëlqyer pedagogjike për të ndihmuar gjeneratat e reja në fushën e artit pamor. ● Organizojnë dhe realizojnë projekte artistike komplekse me mesazhe të fuqishme, duke përdorur qasje inovative dhe teknologji të reja. ● Përballen me kërkesat dhe sfidat e artit bashkëkohor, duke ruajtur një standard të lartë profesionalizmi dhe integriteti artistik. <p>Ky set i rezultateve të të nxënit siguron që studentët do të dalin nga programi me një kombinim të fuqishëm të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave që përputhen me standardet më të larta të artit bashkëkohor dhe kërkesat e tregut artistik global.</p>
--	--

Kontributi në detyrën e studentit (që duhet të përputhet me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditët/javët	Gjithsej
Ligjërata	6	30	180
Ushtrime teorike/laboratorike	2	30	60
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	30	30

Ushtrime në teren	6	2	12
Kollokfiume, seminare	1	8	8
Detyra të shtëpisë	3	30	90
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	20	40
Përgatitja përfundimtare për provim	6	4	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	6	6
Projektet, prezantimet ,etj			
Totali			450

Metodologjia e mësimdhënies:

Metodologjia e mësimdhënies për këtë lëndë bazohet në një qasje të integruar që kombinon mentorimin individual me punën grupore, duke i mundësuar studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese, intelektuale dhe profesionale. Ajo mbështetet në standardet më të larta bashkëkohore të mësimdhënies dhe praktikat më të mira pedagogjike.

1. Qasje Individuale

- **Mentorimi i personalizuar:** Secili student punon ngushtë me mentorin për të zhvilluar planin e punës të bazuar në interesat dhe qëllimet e tyre krijuese.
- **Mbështetje e vazhdueshme:** Mentori ofron udhëzime dhe feedback në çdo hap të procesit krijues, duke ndihmuar në strukturimin e projektit dhe zhvillimin e shprehjes artistike individuale.
- **Diskutime individuale:** Diskutimet rreth punimeve praktike dhe shkrimeve ndihmojnë studentët të thellojnë të kuptuarit dhe të përmirësojnë rezultatet e tyre.

2. Qasje Grupore

- **Ligjërata interaktive:** Temat bashkëkohore dhe historike të artit, teknologjia dhe teknikat e reja diskutohen për të zgjeruar horizontet teorike dhe konceptuale të studentëve.

- **Debate dhe diskutime:** Grupet inkurajohen të ndajnë mendimet e tyre mbi punët personale dhe të artistëve të tjerë, duke zhvilluar mendimin kritik dhe analitik.
- **Punë grupore:** Projekte dhe aktivitete që përfshijnë bashkëpunimin mes studentëve, duke promovuar ndërveprimin dhe ndarjen e ideve artistike.

3. Mësim i Bazuar në Projekte

- **Zhvillimi i projekteve artistike:** Studentët krijojnë projekte të personalizuara të bazuara në një koncept të qartë dhe të strukturuar, duke u fokusuar në mesazhe dhe ide të forta artistike.
- **Progresioni i qartë:** Projektet zhvillohen hap pas hapi, duke filluar nga konceptualizimi, eksplorimi teknik dhe material, deri te realizimi dhe prezantimi përfundimtar.
- **Dokumentimi:** Çdo projekt përfshihet në një dokumentim të detajuar, duke përfshirë skica, hulumtime dhe shkrime që mbështesin procesin krijues.

4. Punë Praktike Intensive në Studio

- **Eksperimentimi me teknika dhe medime:** Studentët inkurajohen të eksplorojnë materiale dhe metoda të reja për të zhvilluar qasje inovative në punën e tyre artistike.
- **Demonstrime teknike:** Profesori dhe mentori ofrojnë demonstrime për teknika dhe qasje të reja që ndihmojnë studentët në përvetësimin e aftësive të avancuara.
- **Feedback i rregullt:** Studentët marrin kritika konstruktive dhe udhëzime për të përmirësuar dhe zhvilluar më tej punën e tyre praktike.

5. Shkrime dhe Hulumtime

- **Shkrime kritike dhe analitike:** Studentët shkruajnë reflektime dhe analiza mbi punën e tyre dhe veprat e artistëve të tjerë, duke u fokusuar në zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive të komunikimit.

- **Hulumtime mbi artin bashkëkohor:** Temat e trajtuara përfshijnë teknikat moderne, teknologjinë, koleksionimin dhe plasimin e artit, si dhe diskutet kulturore që ndikojnë në art.

- **Shkrime semestrale:** Studentët zhvillojnë shkrime të strukturuar që ndihmojnë në përgatitjen e temës përfundimtare të masterit.

6. Prezantime dhe Ekspozita

- **Prezantime në klasë:** Studentët ndajnë punën dhe idetë e tyre përmes prezantimeve, duke praktikuar aftësitë komunikuese dhe mbrojtjen e projekteve artistike.

- **Ekspozita përfundimtare:** Programi kulmon me një ekspozitë ku studentët prezantojnë punët e tyre për publikun dhe mbrojnë temën e masterit para një audience profesionale.

7. Vizita dhe Aktivitetet në Komunitet

- **Vizita në galeri dhe muze:** Studentët marrin pjesë në aktivitete dhe ekspozita për të analizuar punën e artistëve bashkëkohorë dhe për të zgjeruar perspektivat e tyre.

- **Angazhimi në komunitetin artistik:** Studentët inkurajohen të marrin pjesë në ngjarje artistike dhe projekte bashkëpunuese për të zhvilluar lidhje profesionale.

8. Vlerësimi Formativ dhe Përfundimtar

- **Vlerësimi i procesit:** Progresi i studentëve monitorohet përmes feedback-ut të vazhdueshëm dhe kritikave konstruktive gjatë semestrit.

- **Vlerësimi përfundimtar:** Performanca artistike, shkrimet dhe mbrojtja e temës së masterit përbëjnë bazën e vlerësimit përfundimtar.

Metodologjia e mësimdhënies për këtë lëndë mbështet zhvillimin e plotë të studentëve si artistë profesionistë, duke kombinuar punën krijuese, hulumtimin teorik dhe mentorimin individual me qasjen grupore dhe angazhimin në komunitetin artistik. Ky kombinim i qasjeve siguron që studentët të jenë të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e artit bashkëkohor.

METODAT E VLERËSIMIT:	Vlerësimi është i ndarë në katër faza që përfshijnë vijueshmërinë e studentëve, angazhimin në aktivitete të ndryshme, realizimin e projekteve dhe performancën përfundimtare. Secila fazë përbëhet nga afërsisht 8 njësi mësimore, dhe përqindjet e pikëve rriten progresivisht me zhvillimin e studentëve dhe kompleksitetin e detyrave.
------------------------------	---

Faza 1: (20%)

Komponenti	Përqindja	Pikë	Sqarim
Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive	3%	3 pikë	Vlerësohet prezenca dhe angazhimi në ligjërata, diskutime dhe debate.
Detyrat dhe raportimet javore	3%	3 pikë	Vlerësohen detyrat javore dhe raportimet e punës praktike.
Projekti i parë: Skicat fillestare dhe zhvillimi i koncepti	7%	7 pikë	Vlerësimi për progresin dhe rezultatet e projekteve në secilën fazë.
Seminari i parë: “Arti bashkëkohor, arti pas vitit 1970”	4%	4 pikë	Përfshijnë hulumtimet, shkrimet dhe prezantimet për temat e caktuara.
Ese fillestare: “Rëndësia e konceptit në art”	3%	3 pikë	Reflektimi kritik dhe shkrimi analitik mbi temat e artit dhe praktikës.
Totali për Fazën 1	20%	20 pikë	

Faza 2: (25%)

Komponenti	Përqindja	Pikë	Sqarim
Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive	3%	3 pikë	Vlerësohet prezenca dhe angazhimi në ligjërata, diskutime dhe debate.
Detyrat dhe raportimet javore	3%	3 pikë	Vlerësohen detyrat javore dhe raportimet e punës praktike.
Projekti i dytë: Mediumet e kombinuara dhe	10%	10 pikë	Vlerësimi për progresin dhe rezultatet e projekteve në secilën fazë.

aplikimi në punën praktike			
Seminari i dytë: “Hulumtime mbi mediumet e kombinuara”	5%	5 pikë	Përfshijnë hulumtimet, shkrimet dhe prezantimet për temat e caktuara.
Ese: “Ndikimi i konteksteve sociale në art”	4	4 pikë	Reflektimi kritik dhe shkrimi analitik mbi temat e artit dhe praktikës.
Totali për Fazën 2	25%	25 pikë	
Faza 3: (30%)			
Komponenti	Përqindja	Pikë	Sqarim
Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive	4%	4 pikë	Vlerësohet prezenca dhe angazhimi në ligjërata, diskutime dhe debate.
Detyrat dhe raportimet javore	4%	4 pikë	Vlerësohen detyrat javore dhe raportimet e punës praktike.
Projekti i tretë: Piktura konceptuale dhe përgatitja e fazës final	12%	12 pikë	Vlerësimi për progresin dhe rezultatet e projekteve në secilën fazë.
Seminari i tretë: “Ndikimi i teknologjisë dhe piktura digjitale”	6%	6 pikë	Përfshijnë hulumtimet, shkrimet dhe prezantimet për temat e caktuara.
Ese: “Kritika vizuale dhe analiza e veprave”	4%	4 pikë	Reflektimi kritik dhe shkrimi analitik mbi temat e artit dhe praktikës.
Totali për Fazën 3	30%	30 pikë	
Faza 4: (25%)			
Komponenti	Përqindja	Pikë	Sqarim

Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive	3%	3 pikë	Vlerësohet prezenca dhe angazhimi në ligjërata, diskutime dhe debate.
Detyrat dhe raportimet javore	2%	2 pikë	Vlerësohen detyrat javore dhe raportimet e punës praktike.
Projekti përfundimtar: Ekspozita dhe mbrojtja e diplomë	15%	15 pikë	Vlerësimi për progresin dhe rezultatet e projekteve në secilën fazë.
Prezantimi publik dhe interaktiviteti me audiencën	5%	5 pikë	Kulminacioni i punës krijuese dhe prezantimi profesional i punimeve përfundimtare.
Totali për Fazën 4	25%	25 pikë	
Totali i Përgjithshëm	100%	100 pikë	

Shpërndarja e Pikëve për Notat

Pikët < 50	Nota = 5
Pikët >= 50 dhe Pikët <60	Nota = 6
Pikët >= 60 dhe Pikët <70	Nota = 7
Pikët >= 70 dhe Pikët <80	Nota = 8
Pikët >= 80 dhe Pikët <90	Nota = 9
Pikët >= 90	Nota = 10

Literatura

Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> ● 100 Works of art that will define our age/ Kelly Grovier ● Art and Feminism/ Helena Reckitt Peggy Phelan ● Painting today/ Tony Godfrey ● Metodat e pikturimit dhe materialet /METKA KRAIGHER- HOZO ● Historia e artit (The story of Art- vëllimi 3)/ Pierluigi de Vecchi & Elda Cerchiari ● Historia e Artit / H.W. Janson) ● Historia e Artit/ H. Arnason ● Historia e Artit/ E.H. Gombrich
-------------------------	--

	<ul style="list-style-type: none"> ● Monografia e Muslim Mulliqit ● Monografia e Rexhepi Ferrit ● Movements In Modern Art- MINIMALISM/ David Batchelor
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> ● Inkurajohen studentët që të mbledhin dhe shfrytëzojnë informacione mbi teknikat dhe metodat e pikturimit, artin dhe zhvillimet e tij përmes medimeve të ndryshme (internet, medime të shkruara etj). ● Njohuri për ARTIN/ Rosie Dickins dhe Mari Griffith
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java 1:	Prezantimi dhe Hartimi i Strukturës së Studimeve <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: Prezantimi i syllabusit – përshkrimi i lëndës, metodologjia, qëllimet dhe rezultatet e lëndës. ● Punë praktike: Fillimi i projekt-propozimit – skica fillestare dhe identifikimi i konceptit personal.
Java 2:	Planifikimi i Projektit Artistik <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Roli i konceptit në artin bashkëkohor dhe rëndësia e planifikimit të punës artistike". ● Punë praktike: Zhvillimi i detajuar i projekt-propozimit dhe skicimi i ideve për fazën e parë të projektit.
Java 3:	Hulumtime mbi Artin Pas Vitit 1970 <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Arti pas vitit 1970: Lëvizje dhe ndikime në artin bashkëkohor". ● Punë praktike: Pikturimi i fazës së parë të projektit – eksplorimi i ideve konceptuale në mediumet e zgjedhura.
Java 4:	Kritika dhe Vlerësimi Fillestar <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: Prezantimi i projekt-propozimeve të studentëve – diskutim dhe kritikë konstruktive. ● Punë praktike: Përmirësimi i konceptit bazuar në kritikën dhe vazhdimi i punës praktike.
Java 5:	Eksplorimi i Medimeve të Kombinuara

	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Mediumet e kombinuara: Eksperimentim dhe inovacion". ● Punë praktike: Integrimi i teknikave të ndryshme dhe medimeve në fazën e dytë të projektit.
Java 6:	<p>Kritika Vizuale dhe Analizë</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Si të analizojmë dhe interpretojmë veprat e artit bashkëkohor". ● Punë praktike: Prezantimi i punimeve deri më tani dhe përmirësimet bazuar në analizën vizuale.
Java 7:	<p>Roli i Artistit në Shoqëri</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Artisti si krijues dhe aktivist në shoqërinë bashkëkohore". ● Punë praktike: Zhvillimi i punimeve artistike me fokus në temat shoqërore.
Java 8:	<p>Ndikimi i Konteksteve Sociale në Art</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Zhvillimet sociale dhe ndikimi i tyre në artin bashkëkohor". ● Punë praktike: Krijimi i një cikli punimesh që reflektojnë temat sociale të zgjedhura nga studentët.
Java 9:	<p>Teknologjia në Artin Bashkëkohor</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Revolucioni teknologjik dhe ndikimi i tij në artin bashkëkohor". ● Punë praktike: Eksperimentimi me teknika digjitale dhe medime të avancuara.
Java 10:	<p>Diskutime mbi Punën Vizuale</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: Prezantimi dhe diskutimi i fazës së dytë të projektit – kritikë grupore dhe udhëzime. ● Punë praktike: Vazhdimi i punës dhe përmirësimi bazuar në komentet e grupit.

Java 11:	Narrativa në Artin Pamor <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Krijimi i një narrativi vizual në pikturë". ● Punë praktike: Zhvillimi i një serie punimesh që përfshijnë një narrativë vizuale koherente.
Java 12:	Artisti dhe Tregu i Artit <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Tregu i artit bashkëkohor dhe ndikimi i tij në zhvillimin e artistit". ● Punë praktike: Diskutimi i strategjive për vendosjen e veprave në treg dhe zhvillimi i projektit.
Java 13:	Shkrimet Krijuese dhe Katalogu i Punës <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Shkrimi i katalogut të punimeve dhe përgatitja për ekspozitë". ● Punë praktike: Fillimi i strukturimit të katalogut dhe vazhdimi i projektit.
Java 14:	Prezantimi Publik i Artit <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Kurimi i ekspozitës: Rëndësia e prezantimit të artit në publik". ● Punë praktike: Vazhdimi i realizimit të projektit dhe përgatitje për prezantimin e parë publik.
Java 15:	Ndikimi i Disiplinave të Ndryshme në Pikturë <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Aplikimi i elementeve nga disipinat e tjera artistike në pikturë". ● Punë praktike: Eksperimentimi me disiplina të ndryshme artistike për integrim në projekt.
Java 16:	Raportimi i Përparimit <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: Diskutim mbi progresin dhe të arriturat deri më tani. ● Punë praktike: Përmirësimi dhe avancimi i punimeve.
Java 17:	Ndikimi i Kritikës në Artin Bashkëkohor

	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Kritika dhe historia e artit bashkëkohor". ● Punë praktike: Integrimi i analizës kritike në zhvillimin e punimeve personale.
Java 18:	Artisti dhe Institucionet <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Raporti midis artit bashkëkohor, tregut të tij dhe institucioneve". ● Punë praktike: Vazhdimi i projektit dhe diskutimi i ideve për finalizim.
Java 19:	Vazhdimi i Punimeve Praktike <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: Diskutime mbi procesin krijues dhe mbështetja për përparimin e projektit. ● Punë praktike: Puna intensive për finalizimin e fazave të mbetura të projektit.
Java 20:	Seminar mbi Hulumtimet Vizuale <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: Prezantimi i rezultateve nga hulumtimet mbi disiplina të ndryshme të artit vizual. Punë praktike: Integrimi i njohurive të hulumtimit në projekt.
Java 21:	Ndikimi i Historisë dhe Shoqërisë <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Ndikimet historike dhe shoqërore në zhvillimin e artit bashkëkohor". ● Punë praktike: Përmirësimi i punimeve bazuar në tema të përzgjedhura historike dhe shoqërore.
Java 22:	Përgatitje për Ekspozitën <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Organizimi i një ekspozite profesionale dhe vetë-administrimi i artistit". ● Punë praktike: Struktura dhe organizimi i ekspozitës përfundimtare.
Java 23:	Shkrimi Kritik mbi Punët <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: "Shkrimi kritik dhe analiza e veprave artistike".

	<ul style="list-style-type: none"> • Punë praktike: Hartimi i përmbajtjes për katalogun e ekspozitës.
Java 24:	<p>Zhvillimi i Projekteve të Reja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata: Diskutime mbi krijimin e ideve për projekte të reja. • Punë praktike: Eksplorimi i temave dhe medimeve të reja.
Java 25:	<p>Vetë-Administrimi i Artistit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata: "Vetë-administrimi dhe vendosja e artistit në tregun ndërkombëtar". • Punë praktike: Përgatitja për prezantimin final të projektit.
Java 26:	<p>Përgatitje e Mbrojtjes së Diplomës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata: "Si të mbrosh diplomën dhe të paraqitesh profesionalisht në publik". • Punë praktike: Finalizimi i diplomës dhe punimeve të ekspozitës.
Java 27:	<p>Organizimi i Ekspozitës Përfundimtare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata: "Kurimi i ekspozitës: Strategjitë dhe detajet organizative" • Punë praktike: Përgatitja e punimeve për prezantim publik, përfshirë kornizimin, përzgjedhjen e ndriçimit dhe renditjen e veprave në hapësirë.
Java 28:	<p>Finalizimi i Punimeve dhe Katalogut</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata: "Prezantimi dhe mbrojtja: Si të komunikoni punën tuaj artistike" • Punë praktike: Finalizimi i katalogut të ekspozitës përfundimtare, duke përfshirë përshkrimet e punimeve, biografinë e artistit dhe analizën konceptuale.
Java 29:	<p>Ekspozita Publike dhe Kritikë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata: "Kritika dhe ndërveprimi me publikun: Çfarë të prisni gjatë ekspozitës" • Punë praktike: Hapja e ekspozitës për publikun: Prezantimi i punimeve të realizuara para kolegëve, mësimeve dhe publikut.

Java 30:	Mbrojtja Përfundimtare dhe Vlerësimi <ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërati:“Mbrojtja e diplomës: Struktura dhe qasja profesionale” ● Punë praktike:Mbrojtja e diplomës përpara komisionit të fakultetit, duke përfshirë një prezantim të detajuar të punës praktike dhe shkrimeve të realizuara.
Përfundimi i Studimeve	<p>Këto javë përmbyllin ciklin e studimeve master duke u fokusuar te përgatitja dhe prezantimi profesional i punës së studentëve. Rezultati përfundimtar përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ekspozitën profesionale si kulminacion i të arriturave krijuese dhe konceptuale. 2. Mbrojtjen e diplomës përpara komisionit, duke dëshmuar kompetencën artistike, kërkimore dhe intelektuale të studentëve. 3. Një katalog profesional si përmbledhje e arritjeve artistike dhe kërkimore të studentit. <p>Ky përfundim i strukturuar dhe gjithëpërfshirës garanton që studentët të jenë të përgatitur për karrierën e tyre artistike si profesionistë të pavarur dhe të vetë-administruar.</p>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe parimet e integritetit akademik, politikat dhe rregullat e mëposhtme janë përcaktuar për të siguruar një mjedis të drejtë, respektues dhe të orientuar drejt rezultateve të suksesshme akademike.</p> <p>Respektimi i Orarit dhe Pjesëmarrja në Mësim</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Studentët duhet të respektojnë në mënyrë të rreptë orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve. Mosprezenca e paarsyetuar mund të ndikojë negativisht në vlerësimin përfundimtar. ▪ Studenti duhet të njoftojë paraprakisht mësimdhënësin për çdo mungesë të arsyeshme, duke paraqitur dokumentacion përkatës. ▪ Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe diskutime është një pjesë integrale e procesit të nxënies. <p>Pajisjet dhe Përgatitja e Studentëve</p>	

- Studentët duhet të jenë të përgatitur për çdo sesion mësimor, duke sjellë të gjitha mjetet e nevojshme për punë (p.sh., bllokun e skicave, mjete për pikturim, dhe materiale të tjera sipas temave mësimore).
- Mosplotësimi i këtyre kërkesave mund të ndikojë në vlerësimin e tyre në bazë të angazhimit dhe përgjegjësisë.

Sjellja Akademike dhe Etika Profesionale

- Çdo student duhet të tregojë respekt të plotë ndaj mësimdhënësve, kolegëve dhe stafit administrativ. Çdo sjellje e pahijshme, përfshirë fyerjet ose pengesat e qëllimshme gjatë orës mësimore, do të ndëshkohet sipas rregulloreve disiplinore të Universitetit.
- Diskutimet dhe debatet në klasë duhet të jenë konstruktive dhe të bazuara në mirëkuptim dhe respekt reciprok.
- Studentët janë të ndaluar të përvetësojnë punën e tjetrit dhe të paraqesin atë si të tyre. Plagjiatura dhe mashtrimet akademike do të trajtohen sipas masave disiplinore të Statutit.

Ruajtja e Rregullit dhe Qetësisë

- Studentët duhet të sigurojnë që ambienti mësimor të jetë i pastër, i qetë dhe i përshtatshëm për zhvillimin e ligjëratave dhe ushtrimeve.
- Çdo ndotje ose dëmtim i pasurisë së universitetit do të sjellë masa ndëshkimore, përfshirë edhe kompensimin për dëmet.
- Telefonat celularë dhe pajisjet e tjera teknologjike duhet të shkyçen gjatë orëve mësimore, përveç rasteve kur janë të autorizuara nga mësimdhënësi për qëllime mësimore.

Integriteti në Vlerësim dhe Prezantim

- Çdo student duhet të prezantojë punimet e tij/saj të përfunduara me përpikëri dhe në kohë, sipas kërkesave të programit.
- Gjatë provimeve dhe prezantimeve, studentët duhet të respektojnë udhëzimet e dhëna dhe të shmangin çdo formë mashtrimi.
- Çdo formë plagjiature, kopjimi ose ndihme të paautorizuara gjatë provimeve do të ndëshkohet sipas Statutit.

Obligimet e Studentëve ndaj Procesit të Mësimdhënies

- Studentët janë të obliguar të respektojnë autoritetin akademik të mësimdhënësve dhe të ndjekin udhëzimet e tyre për realizimin e projekteve dhe detyrave mësimore.

- Është e detyrueshme që studentët të mbajnë dokumentacion të vazhdueshëm mbi procesin e tyre krijues (ditar pune), i cili do të përdoret për reflektim dhe vlerësim gjatë dhe në fund të semestrit.

Dispozita për Mosrespektim të Rregullave

- Çdo mosrespektim i rregullave të mësipërme do të rezultojë në masa ndëshkimore të përcaktuara në Statutin e Universitetit të Prishtinës. Këto masa përfshijnë:
 - Paralajmërime verbale ose me shkrim.
 - Ulje të pikëve në vlerësim.
 - Përrjashtim nga provimi ose kursi, varësisht nga serioziteti i shkeljes.
 - Vendimet për masat disiplinore do të merren në përputhje me Statutin dhe rregulloret përkatëse të universitetit.

Këto rregulla janë në përputhje të plotë me Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe janë krijuar për të siguruar një mjedis të drejtë, të sigurt dhe të frytshëm për të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor.